



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 553/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Menaxherit të Qendrës së Votimit (QV), Sabri Berisha 3038a në fshatin Gurbardhë komuna e Malishevës, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si e palejuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

## A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjektit politik LDK, me të cilën pretendohet se në QV-në 3038a fshati Gurbardhë ka pasur parregullsi të mëdha, ku iniciuesi i tyre ka qenë menaxheri i QV-së Sabri Berisha, në cilësinë e drejtorit të shkollës në këtë fshat, në të cilin një person votuar deri në 10 herë; Në QV 3038a/01r menaxhimi i votimit nga menaxherët ka qene zero ngase ka pasur prezencë të tepërt të njerëzve në objekt të votimit; si dhe ka munguar ndriçimi në VV; ka pasur votim pa dokument identifikues. Në qendrën e votimit 3032a në fshatin Bajë komuna e Malishevës gjithashtu ka pasur parregullsi ngase ka munguar ndriçimi përgjatë kohës së mbrëmjes.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 4 paragrafi 2 parasheh:

*PZAP-i mund ti hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta parregullta apo të pasafatshme) ankesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, poashtu PZAP-refuzon ankesat të cilat janë të pabazuar, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore.*

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e Panelit të Zgjeruar të datës 16.12.2010, Anr. 490/2010. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa**

A nr. 553/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**

**Ferit Osmani**

